



НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

"PËR PËRDORIM TË BRENDSHËM"

Në mbështetje të nenit 47, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21) dhe nenit 65-d, paragrafi 1 të Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07. 90/09, 67/10, 26/ 13, 15/15, 153/15, 190/16 dhe 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19 dhe 122/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut mori:

VENDIM

për ndryshimin e Vendimit për metodologjinë e përcaktimit të shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut

1. Në Vendimin për metodologjinë e përcaktimit të shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 26/17 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 98/21), në pikën 8, fjalët: "Banka Popullore e përcakton shkallën" zëvendësohen me fjalët: "Banka Popullore përcakton shkallën e nevojshme".

2. Kreu III ndryshohet si më poshtë:

"III. MËNYRA E FUTJES DHE E NDRYSHIMIT TË SHKALLËS MBROJTËSE KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT PËR EKSPOZIMET NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

9. Duke marrë parasysh shkallën e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të përcaktuar në përputhje me pikën 8 të këtij vendimi, Banka Popullore përcakton në bazë tremujore nëse ka nevojë të mos futet, të futet, të rritet, të zvogëlohet ose të lirohet shtresën mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

10. Gjatë përcaktimit nëse ka nevojë të mos futet, të futet, të rritet, të zvogëlohet ose të lirohet shtresa mbrojtëse kundërciklike e kapitalit sipas pikës 9 të këtij vendimi, Banka Popullore mund të marrë parasysh edhe tregues të tjerë të nivelit të rreziqeve sistemore, si për shembull treguesit e tregjeve financiare, tregut të pasurive të paluajtshme, rezistencës së sistemit bankar, ekonomisë vendase etj.

11. Në bazë të nevojës së konstatuar sipas pikës 9 të këtij vendimi, Këshilli i Bankës Popullore merr vendim për shumën e shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit, ku theksohet të paktën:

- data kur bankat janë të detyruara të zbatojnë shkallën e shtresës mbrojtëse kundërciklike, në rast të futjes ose rritjes së saj;
- data kur zvogëlohet shkalla e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit ose kur lirohet kërkesa për shtresën mbrojtëse kundërciklike të kapitalit, duke marrë parasysh përcaktimet e pikës 12, paragrafi 1, të këtij vendimi;
- arsyet e përcaktimit të datës më të shkurtër të zbatimit, në rastet kur nga futja ose rritja e shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit është përcaktuar data e zbatimit, që është më e shkurtër se 12 muaj.

12. Në rast të zvogëlimit të shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose në rast të lirimit të kërkesës për shtresën mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet në Republika e Maqedonisë së Veriut, zvogëlimi, përkatësisht lirimi hyn në fuqi tetë ditë pas botimit të Vendimit për zvogëlimin, përkatësisht lirim të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Banka Popullore boton në faqen e vete të internetit shkallën e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit, në përputhje me ligjin".

3. Në pikën 14, paragrafi 1, fjalia e dytë, fjalët: "pa dallim nëse Këshilli i Bankës Popullore mori apo jo vendim për shkallën e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet ndaj atij vendi" me fjalët: "pa dallim të shumës së shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet ndaj atij vendi".

Në paragrafin 3, nënparagrafi 1 ndryshohet si më poshtë:

„- Sz është shkalla e shtresës mbrojtëse kundërciklike për ekspozimet ndaj vendit Z, e botuar me vendim të Këshillit të Bankës Popullore;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

V nr. 02-15/IX-7/2021
30 qershor 2021
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
Dr. Anita Angellovska-Bezhoska